



Problema me 3 pikë

1. Cili katror është ndarë në 2 forma të ndryshme?




2. Cili është numri më i vogël i shkallëve që zjarrëfikësi duhet të përdorë për të fikur zjarrin, pa kërcyer?



- (A) 4 (B) 5 (C) 6 (D) 7 (E) 8

3. Tabela përmban 28 qeliza të bardha:




Era ngjyros 2 rreshta dhe 1 shtyllë. Një rresht është nga e majta në të djathtë. Një shtyllë është nga lart poshtë. Sa qeliza mbeten të bardha?

- (A) 8 (B) 10 (C) 12 (D) 14 (E) 17

4. Futbollistët me numra nga 1 në 11 qëndrojnë në formë rrethi. Çdo lojtar ia pason topin lojtarit të tretë në të majtën e tij. Lojën e fillon lojtari 1. Kjo mënyrë vazhdon deri në momentin që një lojtar **ka** topin për herë të dytë. Cili është numri i lojtarit që e **pason** topin për herë të fundit?

- (A) 7 (B) 8 (C) 9
(D) 10 (E) 11



5. Martini shkroi 3 numra të njëpasnjëshëm 4-shifrorë radhazi. Motra e tij fshiu disa shifra. Cilat janë shifrat që mungojnë? (nga e majta në të djathtë) (Për shembull, 213, 214, 215 janë 3 numra të njëpasnjëshëm 2-shifrorë.)


 7, 898, 48

- (A) 389, 3, 99 (B) 489, 3, 96 (C) 489, 4, 98 (D) 489, 4, 99 (E) 488, 4, 99






6. Lulja paguan 7 lekë për 3 objekte. Kostoja për çdo objekt është e ndryshme dhe është numër i plotë. Sa kushtoi objekti më i shtrenjtë?

- (A) 2 lekë (B) 3 lekë (C) 4 lekë (D) 5 lekë (E) 6 lekë


7. Një mace rrëzon një bllok nga ndërtimi i Mirit.



Cila do të ishte pamja e këtij ndërtimi **përpara** se blloku të rrëzohej?



8. Aleksi ka një poster Kangur në murin e kuzhinës.





Sa katrorë gri gjenden pas posterit?

- (A) 15 (B) 21 (C) 25 (D) 30 (E) 35

Problema me 4 pikë

9. Ardita dhe Dritani hedhin një monedhë.



Nëse monedha bie në anën gri, fëmija ecën 3 hapa përpara. Nëse bie në anën e bardhë, fëmija ecën një hap pas ose qëndron në pozicionin fillestar. Të dy fëmijët nisin lojën para numrit 1 dhe secili e hedh monedhën 4 herë. Ardita shkoi te numri 4, ndërsa Dritani te numri 8.

Sa herë në total fëmijët panë anën e bardhë të monedhës?

- (A) 1 (B) 2 (C) 3 (D) 4 (E) 5

10. Në një tas ka pesë lloje të ndryshme frutash

Andi pëlqen

Beni pëlqen

Iliri pëlqen


Dani pëlqen

Ermiri pëlqen

Secili merr një fruit që dëshiron. Secili merr një lloj të ndryshëm fruti. Cilin fruit mori Beni?

- (A) (B) (C) (D) (E)

11. Ada ka ndërtuar një kullë me 8 disqe, si në figurë. Ada heq diskun e dytë nga fundi i kësaj kulle. Më pas ajo heq diskun e tretë nga fundit i kullës së re. Pastaj ajo heq diskun e katërt nga fundit i kullës së re. Së fundi ajo heq diskun e pestë nga fundit i kullës së re. Cilën kullë përfiton Ada në fund?




12. Pinguini Piter shkon për peshkim çdo ditë dhe sjell 9 peshq për 2 zogjtë e tij. Çdo ditë, ai i jep 5 peshq zogut të parë që sheh dhe 4 peshq zogut të dytë, të cilët i hanë. Gjatë ditëve të fundit, një zog ka ngrënë 26 peshq. Sa peshq ka ngrënë zogu tjetër?



- (A) 19 (B) 22 (C) 25 (D) 28 (E) 31

13. Mbi 4 rrathë të mbivendosur janë vendosur 7 letra, me numra nga 1 në 7, siç tregohet më poshtë. Shuma e numrave brenda çdo rrethi është 10. Cili numër ndodhet në letrën me shenjën e pikëpyetjes?



- (A) 1 (B) 2 (C) 4 (D) 5 (E) 7



14. Luani dëshiron të formojë një larvë që ka një kokë, një bisht dhe në mes 1, 2 ose 3 pjesë të formave të mëposhtme.



Sa larva të ndryshme mund të formojë Luani pa kthyer përmbys këto forma?

- (A) 3 (B) 4 (C) 5 (D) 6 (E) 7


15. Joni shkruan numrat nga 1 në 4 në një fletë. Më pas e kthen fletën në anën tjetër dhe shkruan numrat nga 5 deri në 8, siç tregohet. Pas kësaj, ai e pret fletën në 4 drejtkëndësha dhe i vendos ato radhazi:



Sa është shuma e numrave në drejtkëndëshat me shenjën e pikëpyetjes?

- (A) 3 (B) 4 (C) 5 (D) 6 (E) 7

16. Një dysheme është e shtruar me 2 lloje pllakash dhe . Pllakat drejtëkëndore kanë përmasat 23 cm × 11 cm. Figura tregon një pjesë të dyshemesë.



Cila është përmasa e pllakave katrore?

- (A) 3 cm (B) 4 cm (C) 5 cm (D) 6 cm (E) 7 cm


Problema me 5 pikë

17. Një nxënës ka 3 letra me numra në to. Shuma e tyre është 782. Fatkeqësisht, një krimb hëngri një pjesë të çdo letre. Sa është shuma e 3 shifrave që mungojnë?



- (A) 8 (B) 9 (C) 10 (D) 11 (E) 12

18. Lura peshon disa blloqe.



Sa peshojnë 3 blloqet e ndryshme së bashku?

- (A) 270 g (B) 280 g (C) 290 g (D) 300 g (E) 310 g

19. Në një ekskursion marrin pjesë 60 nxënës. Kur rreshtohen, ngjyrat e jelekëve të tyre reflektues ndjekin modelin: e verdhë, jeshile, e verdhë, jeshile, ... Ngjyrat e çantave të tyre ndjekin një model tjetër: e kuqe, kafe, portokalli, e kuqe, kafe, portokalli, ... Sa nxënës me jelek të verdhë reflektues kanë edhe çantë portokalli?

- (A) 3 (B) 4 (C) 6 (D) 8 (E) 10

20. Në llogaritjet e mëposhtme, të njëjtat shifra fshihen nën të njëjtat figura. Shifra të ndryshme fshihen nën figura të ndryshme.

$$\begin{aligned} \triangle + \triangle &= \square \bigcirc \\ \bigcirc + \triangle &= \square \square \end{aligned}$$


Cila është vlera e $\triangle \times \bigcirc \times \square$?

- (A) 0 (B) 15 (C) 18 (D) 28 (E) 30

21. Në çdo rresht dhe në çdo shtyllë janë vendosur saktësisht 2 bretkosa. Bretkosat vendosin që 2 prej tyre të hidhen njëherësh në një qelizë boshe fqinje. Qelizat fqinje kanë një brinjë të përbashkët. Pas kësaj, ka saktësisht 2 bretkosa në çdo rresht dhe në çdo shtyllë. Në sa mënyra mund ta bëjnë këtë bretkosat?

- (A) 1 (B) 2 (C) 3 (D) 4 (E) 5

22. Figura e mëposhtme tregon një koshere bletësh me 9 qeliza. Në disa qeliza ka mjaltë. Numri në çdo qelizë tregon sesa qeliza fqinje kanë mjaltë. Qelizat fqinje kanë një brinjë të përbashkët. Sa qeliza përmbajnë mjaltë?



- (A) 4 (B) 5 (C) 6 (D) 7 (E) 8

23. 3 vajza shkojnë njëra pas tjetrës dhe marrin disa biskota nga shporta.




Njëra nga vajzat merr nga shporta të gjitha biskotat në formë zemre. Vajza tjetër merr nga shporta të gjitha biskotat e bardha. Vajza tjetër merr nga shporta të gjitha biskotat e mëdha. Por, ato jo detyrimisht i marrin biskotat sipas kësaj radhe.

Një vajzë merr 3 biskota, njëra merr 6 biskota dhe tjetra merr 7 biskota. Cilin nga grupet e mëposhtme të biskotave merr njëra nga këto vajza?

- (A) ○ ○ ♥ (B) ♥ ○ ○ ○ ○ ○ ♥ (C) ○ ○ ○ ○ ○ ○ ♥
 (D) ♥ ♥ ♥ ♥ ♥ ♥ ♥ (E) ○ ○ ○

24. Janë 2 lloje blloqesh: i bardhë  dhe i kuq .

Një kub i vogël ndërtohet duke përdorur 4 blloqe të bardhë ose 1 bllok të bardhë dhe 1 gri. Një kub i madh, i treguar në figurën më poshtë është i formuar nga kube të vegjël. Cili është numri më i vogël i blloqeve të bardha që nevojiten për të formuar kubin e madh?



- (A) 8 (B) 11 (C) 13 (D) 14 (E) 23